L I G J
Nr.7520, datë 16.10.1991

PËR BANKËN E BUJQËSISË DHE TË ZHVILLIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.l991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të krijohet Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit si institucion i pavarur që bën pjesë në sistemin bankar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit kryen veprimtari bakanre mbi baza tregtare, si dhe financon projekte të ndryshme zhvillimi në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit u jep kredi personave fizikë e juridikë.

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit pranon dispozita të popullsisë dhe të personave juridikë a fizikë vendas a të huaj në lekë e në valutë kundrejt interesit bakanar. Për depozitat e kursimit të popullsisë që administrohen prej saj zbaton dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet në këtë fushë.

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit kryen të gjitha veprimet e tjera bankare e parabankare.

Neni 4

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit u jep kredi ndërmarrjeve shtetërore kundrejt garancisë për kthimin në afat të saj. Me kërkesë të bankës ndërmarrjet shtetërore i paraqesin asaj dorëzani për garanci nga shteti, për kreditë që marrin dhe për kthimin në afat të detyrimeve ndaj bankës.

Neni 5

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit ka këto organe:
a. Këshilli i Bankës
b. Drejtori i përgjithshëm
c. Komisioni i Kontrollit.

Neni 6

Këshilli i Bankës është organ vendimor. Ai përpunon, organizon, drejton dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit.

Këshilli përbëhet nga drejtori, zevëndësi i tij dhe 12 anëtarë. Nga këta 7 anëtarë janë përfaqësues të ministrive e të bankës së Shtetit Shqiptar dhe caktohen nga titullarët e tyre, kurse 5 anëtarë të tjerë caktohen nga Drejtori i Përgjithëm, i cili ka të drejtën e dy votave. Ministritë që do të përfaqësohen në këshillin e Bankës, miratohen nga ministri i Financave. Anëtarët e Këshillit zgjidhen për 5 vjet me të drejtë rizgjedhje edhe për 5 vjet të tjera.

Me shndërrimin e kapitalit shtetëror në aksionar, bëhen ndryshime perpjesëtimore të Këshillit

të Bankës me përfaqësues të aksionarëve.

Neni 7

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit drejtohet e përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në mungesë të tij nga zëvendësi, i cili vepron në përputhje me statutin e saj dhe në pajtim me vendimet e Këshillit, para të cilit ai përgjigjet. Fillimisht Drejtori i Përgjithshëm caktohet nga Këshilli i Ministrave me të drejtë rizgjedhje nga Këshilli i Bankës.

Komisioni i Kontrollit kontrollon zbatimin e statutit dhe të vendimevë të Këshillit të Bankës. Ai e përbëhet nga kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët caktohen nga Këshilli i Bankës.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Bankës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Komisionit të Kontrollit caktohen në Statutin e bankës që miratohet nga Këshilli i saj.

Neni 9

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit ka fondin e saj të themelimit prej 450 milionë lekësh, nga të cilët 300 milionë lekë përdoren për veprimtarinë tregtare të bankës dhe 150 milionë për financimin e projekteve të zhvillimit. Ky kapital mund të shndërrohet edhe në kapital aksionar.

Neni 10

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit është person juridik me qendër në Tiranë.

Për të kryer veprimtarinë e saj Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit, me miratimin e Drejtorit të Përgjithëm, hap degë dhe përgjegjësi i degës hap agjenci në përputhje me nevojat dhe interesat e saj.

Neni 11

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit paguan tatime sipas ligjit. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përjashtojë Bankën e Bujqësisë dhe të Zhvillimit nga pagimi i tatimeve deri në krijimin e plotë të fondit të themelimit të saj.

Neni 12

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit mban sekret të gjitha marrëdhëniet me klientët e saj në lidhje me dispozitat dhe llogaritë e tyre, si dhe me veprimet që bëhen për to.

Neni 13

Veprimtaria e kreditimit të Bankës Bujqësore i kalon Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit, bashkë me shërbimet e tjera bankare.

Kreditë që u janë dhënë nga Banka Bujqësore klientëve privatë kalojnë në aktiv të Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit.

Detyrimet e Bankës Bujqësisë që rrjedhin nga kreditë e pakthyera të ndërmarrjeve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore i kalojnë shtetit.

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit ngarkohet të kryjë shërbimin e arkëtimit të kredive të pakthyera për llogari të buxhetit të shtetit.

Neni 14

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit ka vulën dhe shenjat e saj.

Neni 15

Ligji nr.7378, datë 8.5.1990 "Për Bankën Bujqësore", shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.66 datë 29.10.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia